



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:218032

Datë: 05.08.2024

Numri i dokumentit: 06016683

2023:218033

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Pergjithshem-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çeshtjen penale ndaj të pandehurit M.B nga fsh...-Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.495/23 të datës 16.10.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.10.07.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Ardian Emimi, përfaqësuesit të dëmtuarës F. L. dhe të pandehurit, me dt.16.07.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me dt. 05.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri M.B nga fshatin ..., Komuna Kaçanik i lindur më dt.... nga i ati Sh... dhe e ëma Sh..., e gjinisë I..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar prind i 3 femijeve, ka të kryer shkollës fillore, i pa punë, I gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal:.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt. 15 Mars 2023, rreth orës 16:20, në pyllin publik i cili menaxhohet nga Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari në Kaçanik, në vendin e quajtur “Kotar”, me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë 60 copë drunjë të llojit ahu, shkoz dhe qarr, me diametër 10-15 cm, me vëllim të përgjithshëm prej 2.35 m³, të cilat i ka qenë duke i bartur me dy mushka me samar deri te automjeti kombi me targa ..., pa poseduar leje nga organet kompetente për prerjen e drunjëve, me ç’rast sipas të dëmtuarës, Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari në Kaçanik, është shkaktuar dëm në shumën prej 338.40 €,

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,43,69,70 të KPRK-së, dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 700.00 € (shtatëqind euro).

I pandehuri është i obliguar që dënimin me gjobë t’u paguajë brenda afatit prej 30 ditësh, por jo me gjatë se dy muaj pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe ate në tri këste.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën , gjykata do t’u zëvendesoje dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumen prej 20 € për çdo ditë burgu.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë pranë kësaj gjykate, shumën prej 50.00€, ndërsa për Fondin për Kompensimin e Viktimave te Krimet shumën prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

E dëmtuara, DBZHRP-Komuna Kaçanik, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.495/23 të datës 16.10.2023, të pandehurin M.B nga fsh.....-Ferizaj, e ka akuzuar për veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Ne bazë të kësaj aktakuze gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt.24.01.2024, me të cilin rast i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Ne shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.10.07.2024, prokurori i shtetit nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, Ardian Emini, mbeti në tërësi pranë aktit akuzues të paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate pa ndryshime dhe plotesime. Në fjalën përfundimtare ka theksuar se, pas administrimit të provave personale dhe materiale gjatë shqyrtimit gjyqësor, u vërtetua se I pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj edhe I ka propozuar gjykatës që i pandehuri, të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksion penal sipas ligjit, duke patur parasysh si rrethanë rënduese faktin se I njejtë është recidivist, pa propozuar edhe ndonjë rrethanë lehtësuese.

Përfaqësuesi I të dëmtuarës në fjalën e tij, I bashkangjitet ndjekjes penale dhe parashton kërkesë pasurore juridike në vlerën si në aktakuzë, dhe njëherit mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit.

I pandehuri M.B, në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vëhet në barrë sipas aktit akuzues. Në mbrojtjen e ka theksuar se ditën kritike, në vendin e cekur si në aktakuzë shtë e vërtetë që është takuar nga rojet e pyllit: Xh.T., B. D. dhe Q. K., gjersa i pandehuri kishte qenë me dy mushka dhe sharrë motorrike, por arsyetohet se atë ditë kishte shku për të prerë dru në një zabel privat, por pasi që i kishte vërejtur rojet e pyllit, nuk kishte prerë, meqë nuk ka patur leje për prerje, ndërsa drutë të cilat kanë qenë afër automjetit-kombit të tij nuk i ka prerë ai, derisa pranon se ka patur herë të tjera, kur e kanë takuar këtpo roje pylli duke prerë dru në pyllin pronë publike.

Gjykata ne shqyrtimin gjyqësor prezantoi provat e propozuara me dëgjimin e dëshmitarëve: Xh. T., B. D. dhe Q.K., leximin e fletparaqitjes me nr.41/23 të dt.04.04.2023 , deklaratës së të pandehurit të dt.04.10.2023 dhe shiqimin e fotografive të bashkangjitura në shkresat e lëndës.

Pas prezantimit të provave dhe vlerësimit të tyre të plotë, secilën veç e veç dhe të gjitha në tërësi, mbrojtjes së të pandehurit si dhe bindjes së lirë të gjykatës, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv.

Nga deklarata e dëshmitarit Xh.T., gjykata vërtetoi se me datën, kohën dhe vendin e cekur si në aktakuzë, duke qenë në detyrë si roje e pyllit, bashkë me kolegët e tij-roje pylli: Q. K. dhe B.D., pasi që kishin vërejtur një grumbull të drunjve të prerë, dhe pasi që në atë vend vie edhe I pandehuri me dy mushka të pangarkuar me dru dhe me vete kishte edhe sharrën motorrike, bazuar në gjurmët e këtyre mushkave është identifikuar vendi i prerjes së këtyre drunjve, përmasat e të cilave kanë qenë të njëjta me ato të grumbulluara afër automjetit-kombit të të pandehurit. Nga kjo dëshmi, poashtu u vërtetua se afër drunjve të grumbulluar kishte gjurmë të mushkave të cilët I pandehuri I kishte me vete, dhe nuk kishte gjurmë të tjera, dhe se prerja e drunjve ishte e freskët, ndërsa përveq të pandehurit nuk ka qenë dikush tjetër atypari, dhe se fotografitë e bashkangjitura në shkresat e lëndës janë bërë nga dëshmitari.

Nga deklarata e dëshmitarit, B. D., Gjukata vërtetoi se, vendi i prerjes së drunjve, nuk ka qenë më larg se 100 metra nga drunjët e grumbulluar afër automjetit-kombit të të pandehurit, dhe se në distancën nga vendi i prerjes së drunjve e deri të drunjët e prerë të grmbulluar, ka patur gjurmë të mushkave të cilët I ka patur I pandehuri, por edhe faktin se I pandehuri kishte me vete sharrën motorrike dhe se prerja ishte e freskët,

Fakte të njëjta janë vërtetuar edhe nga dëshmia e dëshmitarit Q. K., leximi i fletëparaqitjes me nr.41/23 të dt.15.03.2023 dhe shiqimi i fotografive të bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe pjesërisht edhe deklarata e të pandehurit e dhënë në Stacionin Policor në Kaçanik me dt.04.10.2023.

Gjukata u falë besimin këtyre dëshmimeve, meqë të njëjtat gjejnë mbështetje në njëra tjetrën dhe në provat materiale të administruara dhe sepse me të njëjtat në mënyrë të qartë dhe bindëse është përshkruar koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale.

Gjukata vlerësoi posaçërisht edhe mbrojtjen e të pandehurit, se I njëjti ditën kritike kishte qenë në vendin e cekur si në aktakuzë për të prerë dru në një zabel privat, mirëpo nuk kishte prerë, pasi që e kishte vërejtur se kishin ardh rojet e pyllit-dëshmitarë të rastit konkret, mirëpo një mbrojtje të tillë gjykata nuk mund t'i falë besimin, meqë ishin dëshmitarët: Xh.T., B.D. dhe Q.

K., por edhe fotografitë e shkresave të lëndës, prova këto të cilat dëshmuajnë se I njejtë ka qenë në vendin e ngjarjes duke e patur me vete sharrën motorrike, mushkat dhe automjetin-kombin, dhe se prerja e drunjve ishte e freskët, dhe duke patur parasysh edhe faktin se I njejtë është edhe përsëritës i këtyre veprave, Gjykata vlerësoi se I pandehuri, përmes kësaj mbrojtje vetëm ka tentuar që t'i shmanget përgjegjesisë penale për rastin në fjalë.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që rrethanë lehtësuese gjykata nuk gjeti, ndërsa rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti faktin se i njëjti, bazuar në evidencën e gjykatës, ka patur edhe raste tjera kundërvajtëse dhe penale, të natyrës së njëjtë dhe shkallën jo të vogël të dëmit të shkaktuar pyllit publik, të cilit i duhet një kohë relativisht e gjatë për t'u rivitalizuar.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin M.B, i akuzuar për veprën penale, , Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla penale dhe se me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEGA KAÇANIK

2023:218033 datë 05.08.2024

Sekretarja juridike,
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimet. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.